

Fjalët dhe shprehjet më të shpeshta në veprën e Kadaresë

Agim SPAHIU

16 nëntor 2012

Përmbledhje

Në këtë shkrim është vënë në dukje frekuenca e fjalëve apo e fjalëzave të vetme, si elemente të vetme tingullore-gjuhësore, të togjeve të fjalëve dhe të shprehjeve në veprën "**Gjakftohtësia**" të **Ismail Kadaresë**, botuar kohë më parë në rrjetin elektronik. Zbërthimi dhe përcaktimi numerik i tyre është bërë me anë të programit [antconc](#).

1 Të përgjithshme

Në gjuhën shqipe janë bërë shumë analiza e studime teorike për vepra të letërsisë artistike të autorëve tanë e të huaj. Por, sa i përket ndonjë analize kuantitative-statistikore (matematikore), kjo ka mbetur pothuajse një fushë "gati e paprekur" ose në nivelin "e hapave të parë". Kjo gjendje, sipas mendimin tonë, ka mbetur kështu, në radhë të parë, për shkak të mungesës së digjitalizimit elektronik të tyre, pra edhe të autorëve më eminentë, siç është rasti me veprat e Kadaresë e ndonjë tjetri, parakusht ky pa të cilin nuk do të ketë mundësi të kryhej asnjë lloj analize e studimi të këtij niveli. Kështu qëndron puna edhe me fushat e tjera shkencore, publicistike etj. Madje ato studime a analiza të pakta gjuhësore-kuantitative që janë bërë deri më sot, janë realizuar me vështirësi të mëdha, meqë krejtësisht janë bëra në mënyrë mekanike dhe, për rrjedhojë, shpeshherë edhe rezultatet e duhura kanë munguar ose nuk kanë qenë gjithmonë të sakta. Prandaj për të pasur studime të mirëfillta të kësaj natyre, duhet që së pari i tërë korpusi gjuhësor i shqipes të digjitalizohet (që nga shkrimet e para e deri më sot), në mënyrë elektronike. Ky digjitalizim i korpusit gjuhësor do t'ju japë mundësi studiuesve t'ju qasen këtij materiali edhe nga këndvështrime të ndryshme dhe të mos mbesim gjithmonë prapa të tjerëve. Pra, kjo është një kërkesë imediate që duhet të kryhet pa humbur shumë kohë. Dhe mungesa e studimeve të kësaj natyre na nxiti që sot t'ju rrekem kësaj problematike, në mënyrë që sado pak të japim një kontribut modest, në këtë drejtim, duke e marrë për bazë përmbledhjen "**Gjakftohtësia**" të Ismail Kadaresë dhe duke e vështruar kryesisht frekuencën e ndërtimeve gjuhësore në të nga aspekte të ndryshme. Në këtë përmbledhje janë përfshirë: **Gjakftohtësia**, **Kush e solli Doruntinën**, **Prilli i thyer**, **Lëkura e daulles**, **Nëpunësi i pallatit të ëndrrave**, në një tekst prej 489 faqesh.

Në këtë shkrim, me ndihmën e programit [antconc](#) e kemi zbërthyer dhe analizuar korpusin gjuhësor të veprës të përmendur dhe kemi nxjerrë disa përfundime, të cilat, për mendimin tonë, janë shumë të rëndësishme. I konsiderojmë të rëndësishme për vetë faktin se ne vetë dhe çdokush tjetër kishte me qenë kureshtar të dijë se sa fjalë, p. sh. përmban kjo përmbledhje me vepra letrare, si korpus gjuhësor, në tërësi, cila është fjala më e shpeshtë të cilën e përdor ky autor dhe cila jo, cili është togu dhe togfjalëshi më i shpeshtë (i përbërë prej dy, tri a i më shumë fjalësh), cilat janë shprehjet më të shpeshta dhe cila është konkordanca e tyre në raport me fjalët paraprijëse dhe atyre që vijnë pas, etj. etj.

2 Njëgramet dhe konkordanca e disave prej të tyre

Duke e shfrytëzuar opsionin *Word List* dhe *n-Gramm*-et nga komponentja *Clusters* të këtij programi e kemi zbërthyer këtë përmbledhje të veprës së Kadaresë dhe na kanë dalë këto rezultate: Ky tekst ka 159189 fjalë ose Tokens, (term që përdoret në gjuhën angleze për fjalët që janë të përgjithshme të një korpusi gjuhësor), në përgjithësi, kuptohet me përsëritje, mirëpo fjalë të papërsëritura ose Types ka 15232 sosh. Dhe nga ky seleksionim është hartuar lista në të cilën, sipas ranglistës, fjala apo elementi më i shpeshtë gjuhësor del fjalëza **të** më së *9335* herë, në të dytën vjen fjalëza **e** me 9018 herë, në të tretën parafjala **në** me 3835, e kështu më radhë. Pra, nëse kjo shprehet me përqindje del se vetëm fjalëzat **të** dhe **e** përbëjnë diku nga 17 për qind, kurse parafjala **në** 7 për qind. Dhe, nëse zbresim menjëherë në numrin rendor 10, në të cilin është radhitur fjalëza **më**, shohim se ajo përdoret vetëm 3 për qind. Për lexuesit është me interes të shohin këtë ranglistë të fjalëve, të cilën po e paraqesim në tërësi me tabelën që mban emrin: [1. Fjalët më të shpeshta](#). Po këtu, kemi prezantuar edhe konkordancën e fjalëzës **të** në një tabelë të veçantë me emërtimin: [2.1.Konkordanca e fjalëzës të](#). Në këtë tabelë, në radhitjen 1. kjo fjalëzë është një e përemrit lidhor i cili në rasën gjinore, në raport me fjalën paravajtëse *fytyra*, përbën një sintagmë me vlerën e përcaktorit me drejtim; edhe në konkordancën e dytë *mezi dallohej pas xhamit të portinerisë* fjalëza **të** del me vlerën e përcaktorit me drejtim të emrit *xham*-i në rasën rrjedhore, kurse në të tretën: *nisi të ngjiste shkallët*, **të**-ja është pjesëz që formon lidhoren e foljes dhe kështu, së bashku përbëjnë një kallëzues të përbërë foljor;në të katërtën: *Në korridorin e katit të dytë të-ja* është një e numërorit rreshtor; në të pestën: *u përplas me të njohurin*, po ashtu, një, por në këtë rast një e mbiemrit të emëruar; në të gjashtën *me të njohurin e saj të dikurshëm* si një e mbiemrit të caktuar; etj.

3 Dygramet dhe konkordanca e togut *do të*

Në tabelën [2. Dygramet](#), kemi paraqitur dygramet, në të cilën mund të vëmë re se togu **do të**, ka shkallën më të lartë të shpeshtësisë, paraqitet më së 603 herë, në të dytën togu i paskajores **për të** më së 520 herë, në të tretën përemri pronor **e tij** e kështu me radhë. Ndërsa, sa i përket konkordancës së dygramit **do të**, atë e gjejmë të përdorur kryesisht si trajtë morfologjike për ta shprehur të ardhmen e së shkuarës të dëftores, të tashmen

e kushtores etj. Shih për këtë tabelën: [2.2. Konkordanca e dygramit](#).

4 Trigramet dhe konkordanca e togut *më në fund*

Në tabelën [3.Trigramet](#) kemi prezantuar të gjitha trigramet që paraqiten në këtë vepër. Dhe, sikundër mund të shihet në këtë tabelë, trigrami më i shpeshtë është shprehja ndajfoljore **më në fund**, që përdoret 109 herë, i pasuar nga lokucioni lidhëzor në qoftë se me 86 herë dhe shprehja tjetër ndajfoljore e kohës **një copë herë** me 85 herë, e kështu më radhë. Në tabelën [2.3 Konkordanca e trigramit](#) kemi prezantuar të gjitha rastet konkordante të shprehjes ndajfoljore **më në fund**.

5 Katërgramet

Sa u përket katërgrameve, Kadareja në veprat e tij më së shpeshti ka përdorur shprehjet **me zë të ulët**, gjithsej 27 herë, pastaj **në fund të fundit** 26 herë, **në një mënyrë të**, 23 herë, **një gjë të tillë**, 18 herë e kështu më radhë. Këtë lexuesi mund ta shohë edhe në kuadër të tabelës [4. Katërgramet](#), të cilën po e prezantojmë këtu më poshtë.

6 Pesëgramet

Te pesëgramet, ([5. Pesëgramet](#)) vendin e parë e ka zënë shprehja **ishte hera e parë që**, e përdorur në këtë tekst 10 herë, e pasuar nga shprehja **në një mënyrë të**, 9 herë e kështu me radhë.